

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bonnie Greer, shkrimtarja britaniko-amerikane ndahet nga jeta në moshën 77-vjeçare... Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/bonnie-greer-shkrimtarja-britaniko-amerikane-ndahet-nga-jeta-ne-moshen-77-vjecare/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:46:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:37:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	79c1443db614266bb27c02063beaa08ac9a8abf61c85cd5cb7ce940af4b2bbd8
TEKSTI	5f877d1567d992a8ba09f40e4909a8b3006d41cf71635d576af2662edf065a00
PAMJA	794dea3e392067cf5344dc612ef6daa7404f52e7d3e50b4272d8a3f6f3c5a56f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e7db7bb0a7e3f2ca5e1cac0bab4cf04ce9558f628ebcf1885d5d5e0846ba8df
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e7db7bb0a7e3f2ca5e1cac0bab4cf04ce9558f628ebcf1885d5d5e0846ba8df>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Bonnie Greer, shkrimtarja britaniko-amerikane ndahet nga jeta në moshën 77-vjeçare...

Eriselda Doko
16 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Romancierja, dramaturgia dhe komentatorja britaniko-amerikane Bonnie Greer ka ndërruar jetë në moshën 77-vjeçare, pas një sëmundjeje.

Lajmin e bëri të ditur bashkëshorti i saj, David Hutchins, i cili tha se Greer vdiq të martën në mbrëmje.

"Inteligjenca, guximi dhe zëri dallues i Greer dhanë një kontribut të qëndrueshëm në jetën kulturore dhe publike britanike", tha Hutchins, duke e përshkruar atë si partneren, shoqen e tij të besuar dhe frymëzimin e tij.

Greer lindi më 16 nëntor 1948 në Shtetet e Bashkuara dhe u zhvendos në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1986. Ajo u bë shtetase britanike në vitin 1997.

Gjatë karrierës së saj, Greer shkroi romane, vepra jofiksion, drama dhe artikuj opinioni, ndërsa puna e saj shpesh trajtonte jetën e minoriteteve dhe grave.

Libri i saj i parë, "Hanging By Her Teeth", u botua në vitin 1994 dhe rrëfente historinë e një gruaje me ngjyrë amerikane që udhëtonte nëpër SHBA dhe Evropë në kërkim të babait të saj. Ndër veprat e saj të tjera janë "Obama Music", botuar në vitin 2009, "Langston Hughes: The Value of Contradiction", një biografi e figurës së Rilindjes së Harlemit, si dhe kujtimet "A Parallel Life", të botuara në vitin 2014.

Greer ishte gjithashtu një zë i njohur në mediat britanike. Ajo shkroi për botime si Guardian, Independent dhe New Statesman dhe u shfaq rregullisht si paneliste në programe të çështjeve aktuale, përfshirë "Newsnight Review" dhe "Question Time".

Në një nga episodet më të diskutuara të "Question Time", ku ishte e pranishme edhe përkatës liderit të Partisë Kombëtare Britanike, Nick Griffin, Greer e shndërroi përvojën në frymëzim për një operë, "Yes".

Ajo sherbeu gjithashtu ne bordet e Royal Opera House, British Museum dhe London Film School, ndërsa ishte edhe kancelare e Universitetit Kingston në Londër.

Në vitin 2010, Greer u nderua me titullin OBE për kontributin e saj në arte. Në vitin 2022, ajo u bë anëtare e Shoqërisë Mbretërore të Letërsisë.

Pas lajmit për vdekjen e saj, autorja Bernardine Evaristo e kujtoi Greer si një nga komentaret më të rëndësishme dhe më të njohura të kulturës me ngjyrë në Mbretërinë e Bashkuar gjatë viteve '90 dhe 2000.

Edhe ish-zëvendëskryeministri britanik David Lammy e përshkroi Greer si “një fjalëshkruese dhe artiste të fuqishme”, duke shtuar se ajo ishte “elokuente dhe kërkuese” dhe “një forcë e vërtetë jetësore”.

Bashkëshorti i saj tha se njerëzit më të afërt me Greer do ta kujtojnë për ngrohtësinë, humorin, bujarinë dhe aftësinë e saj të jashtëzakonshme për të bashkuar njerëzit.

LAJME TË NGJASHME



Gjermani, arrestohet vrasësi i shkrimtares së njohur/Pranga të birit!
1 MIN



Regjizorja dhe dramaturgia dënohen me burg në Rusi për terrorizëm në një pjesë teatrale!
1 MIN

MË TË LEXUARAT



Sot verdikti i Hagës/ Konjufca: Presim vetëm një vendim, lirim të katër ish-krerëve të UÇK-së



Charles Smith kryeson trupin gjyqes në Hagë



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Trupi gjyqes: Të katër ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte



Gjykata speciale në Hagë jep sot vendimin për Thačin dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Kush janë gjyqtarët që do të shpallin sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së në Hagë?



Nis seanca në Hagë për shpalljen e vendimit për Thačin, Veselin, Selimin e Krasniqin



Në lidhje me Jonida Maliqin?
Alessio vihet në siklet: "Ja
kalojmë shumë mirë, na bëjnë
foto sepse..."



Një natë, shumë ritme dhe një
ndalesë që nuk e kishim
planifikuar!



Nga dëshira për të prekur
"Eurovisionin" deri tek situata
më e sikletshme në koncert, flet
Lorenc Hasrama!



"Po sikur...?" Ja si mendimet më
të zakonshme na fusin në alarm...



"Po du", Rilind Alimani tregon si
arriti të realizojë bashkëpunimin
me Elvana Gjatën: I kam shkruar
që...



Truku i thjeshtë që ua heq
lëkurën specave pa mundim,
mjafton një hap pas pjekjes!



"Eksperimentova, shkoj shumë
mirë"/Egli Tako flet për projektet
e saj muzikore: Do kthehem tek
baladat...



Të dobët dhe e keni të vështirë të
shtoni peshë?! Proveni këto
ushqime...



Të gjithë po shtojnë ekrane,
Range Rover po bën të
kundërtën!



Jeni të mërzitur?! Bëni mirë të
hani këto ushqime...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të
zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet
informativ dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,
Albania

Email:

Tel: +355 69 208 0500

+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top
Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo
riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.